

L I G J
Nr.8495, datë 3.6.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT PËR STATUSIN E
ZYRËS SË SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT TË EUROPËS NË TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe të nenit 121 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Memorandumi i mirëkuptimit për statusin e zyrës së Sekretariatit të Këshillit të Europës në Tiranë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2387, datë 7.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË LIDHJE ME STATUSIN E ZYRËS SË
SEKRETARIATIT TË KËSHILLIT TË EUROPËS NË TIRANË**

Marrëveshja e propozuar, që është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë më 26 tetor 1998, është si më poshtë:

1. Republika e Shqipërisë do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e plotë, sigurinë dhe sigurimin e zyrtarëve të Këshillit të Europës, si dhe lokalet dhe mjetet të vëna në dispozicion të Zyrës së Sekretariatit të Këshillit të Europës.

2. Zyra e Sekretariatit të Këshillit të Europës dhe zyrtarët e Organizatës të caktuar me detyrë në Republikën e Shqipërisë do të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në nenet 3 deri 8, 18, 19 dhe 21 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Europës të 2 shtatorit 1949.

3. Autoritetet e Republikës së Shqipërisë do të hyjnë në lokalet e Zyrës vetëm me miratimin e shprehur ose me kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës ose të Përfaqësuesit të tij të Posaçëm. Në rast zjarri, miratimi i këtij të fundit do të presupozohet.

4. Zyra e Sekretariatit të Këshillit të Europës dhe zyrtarët e tij janë të lejuar të paraqesin emblemën e Këshillit të Europës në lokalet e përdorura nga Zyra, si dhe mjetet e transportit pa taksë.

5. Në ushtrimin e së drejtës së komunikimit të pakufizuar (neni 8 i Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Europës), Zyra mund të shfrytëzojë kanalet e komunikimit, mjetet dhe shërbimet që kërkohen për të siguruar aftësinë e plotë të komunikimit. Zyra, në pajtim me ligjet dhe rregullat e Shqipërisë, mund të përdorë spektrin elektromagnetik për veprimtaritë e Zyrës, dhe merr përsipër të sigurojë licencat, në bashkëpunim

me autoritetet përkatës të Shqipërisë. Zyra nuk ka të drjetë të përdorë frekuencat e radios. Zyra mund të përdorë rrjetet e radios VHF/HF të organizatave të tjera ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri. Duke vepruar kështu, ajo do të procedojë në përmbushjen e kërkesave rregulluese për marrjen e licencave për të gjitha pajisjet ekzistuese prej autoriteteve kompetente shqiptare. Zyra mund të transportojë postën private tek ose prej zyrtarëve të caktuar për të punuar në Zyrë.

6. Zyra e Sekretariatit të Këshillit të Europës dhe zyrtarët e saj që do të zhvillojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, do të gëzojnë të gjitha privilegjet dhe përjashtimet tatimore, ashtu si përfaqësitë dhe diplomatët e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, lidhur me tatimin mbi të ardhurat personale, kontributin e sigurimeve shoqërore, akcizat, tatimin mbi vlerën e shtuar dhe taksat e automjeteve që lidhen me veprimtarinë e kësaj zyre në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Konventën e Vienës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961.

7. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të specifikuara në nenin 18 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Imunitetet dhe Privilegjet e Këshillit të Europës, Përfaqësues-it/et të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe bashkëshort-et/it dhe fëmijëve të tij/saj të mitur, do t'i jepen privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësitë që i garantohen kryetarëve të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Shqipërisë.

8. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të specifikuara në nenin 18 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Imunitetet dhe Privilegjet e Këshillit të Europës, zyrtarët e Këshillit të Europës të caktuar me detyrë në Republikën e Shqipërisë:

a. do t'u lëshohet, së bashku me bashkëshortet dhe personat në ngarkim të tyre, leje qëndrimi për kohën e qëndrimit në detyrë në Republikën e Shqipërisë;

b. do të gëzojnë liri të pakufizuar lëvizjeje dhe të drejtë të pakufizuar hyrjeje kudo në Republikën e Shqipërisë, e cila mund të kërket me qëllim kryerjen e mandatit të Zyrës.

9. Këshilli i Europës do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për emrat dhe funksionin e zyrtarëve të caktuar me detyrë në Republikën e Shqipërisë.

10. Zyra do të ndihmohet që të përfitojë me tarifatat më të ulta të aplikueshme, shërbimet e nevojshme dhe ato publike, si uji, elektriciteti, telefoni, si dhe burimet e tjera për qëllimet e Zyrës.

11. Patentat e automjeteve të lëshuara për zyrtarët e Këshillit të Europës nga autoritetet respektive shtetërore të tyre do të njihen dhe pranohen si të vlefshme pa ndonjë procedurë administrative vendore. Automjetet në përdorim të zyrës ose zyrtarëve të Këshillit të Europës të caktuar me detyrë në Zyrë nuk do t'u nënshtrohen kërkesave për licencim apo regjistrim lokal dhe përdorimi i targave të huaja do të pranohet pa kërkesa të mëtejshme. Automjetet në përdorim të Zyrës ose zyrtarëve të Këshillit të Europës do të kenë sigurimin e duhur të një pale të tretë.

12. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të marrë të gjitha masat për të lehtësuar hyrjen dhe qëndrimin e përkohshëm në Republikën e Shqipërisë të çdo zyrtari të Këshillit të Europës me mision të shkurtër dhe të çdo personi tjetër që i shoqëron këta zyrtarë ose që është ftuar nga Këshilli i Europës. Në rastet kur është e mundur, vizat do të jepen falas. Privilegjet dhe imunitetet e përmendura më sipër në pikat 2 dhe 8 do të njihen, për aq sa është e zbatueshme, ndaj çdo zyrtari të Këshillit të Europës me mision të shkurtër në Republikën e Shqipërisë.

13. Zyrtarët e Këshillit të Europës me detyrë në Republikën e Shqipërisë do të respektojnë normat vendore dhe nuk do të kryejnë veprimtari në kundërshtim me mandatin dhe detyrën e Zyrës.

14. Personeli vendor i punësuar nga Këshilli i Europës do t'i nënshtrohet ligjeve dhe rregullave në Republikën e Shqipërisë, në veçanti në fushën e sigurimit social. Megjithatë, personeli vendor i punësuar nga zyra:

a. do të ketë imunitet nga juridiksioni gjyqësor në lidhje me të gjitha aktet e kryera prej tij në kuadrin e detyrës si punonjës të Këshillit të Europës;

b. do të përjashtohet nga shërbimet kombëtare dhe/ose detyrimeve të shërbimit ushtarak;

c. do të përjashtohet nga taksimi mbi rrogat dhe të ardhurat e marra prej Këshillit të Europës;

d. në rastet kur bëhet fjalë për heqjen e imunitetit të tyre, neni 19 i Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Imunitetet dhe Privilegjet e Këshillit të Europës, do të zbatohet mutatis mutandis.

15. Mosmarrëveshjet ndërmjet nënshkruesve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në rrugë diplomatike.

16. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të zbatohet mbi baza provizore me marrjen e përgjegjes suaj. Ai do të hyjë në fuqi ditën që palët do të njoftojnë njëri-tjetrin për plotësimin e kërkesave të tyre ligjore.